



LIBRI I PARË I NJË FËMIJE PËR MARTESËN

*Mënyra e Perëndisë
është gjithnjë
më e mira*

JANI
ORTLUND



*I kushtohet:
Kate, Zach, Will, Lizzie, Nathan, Jack, Jeremiah,
Micah, Dsaiah, Chloe, Naomi, Ben, Elijah,
deri në brezin e dhjetë.*



Ky libër i jepet

me dashuri nga



Nëse je nënë, gjyshe apo dikush që ka nevojë për një dhuratë fëmijësh, ky libër është për ty! Me ilustrime tepër të mira, ai ndan me çiltërsi të vërtetën e Perëndisë për martesën, ndërkohë që merret dhe me çështje të vështira. Është një pikënisje shumë e mirë për fëmijët e vegjël.

SUSAN ALEXANDER YATES

Autore e And Then I Had Kids and Risky Faith

E admiroj Jani Ortlund për shumë arsye. Një nga këto arsye është shembulli që ajo jep si një mësuese e urtë dhe kultivuese e brezit të ardhshëm. Ky libër është shembulli i përsosur i asaj udhëheqësie. Shumë njerëz hamendësojnë se martesë është diçka për të cilën njerëzit duhet të fillojnë të mendojnë, kur janë rreth të njëzetave apo të tridhjetave. Gjithsesi, Perëndia e projektoi martesën për të na mësuar rreth Tij. Kjo është e vërtetë jo vetëm për ata që janë të martuar, por edhe për ata që do të martohen një ditë. Ky libër i njuh fëmijët me bukurinë e tablosë së ungjillit të Perëndisë në martesë dhe në familje, në një mënyrë që fëmijët mund ta kuptojnë dhe ta duan.

RUSSELL MOORE

President i The Ethics and Religious Liberty Commission of the Southern Baptist Convention

Plot me urtësinë që ka Jani, ky libër i vogël do të jetë një ndihmë e madhe për çdo prind, që kujdeset vërtetë të ushqejë dhe të formësojë zemrën e fëmijës së vet. Ky libër e bën këtë me gjërat që kanë vërtetë rëndësi, në një kohë kur ato kanë gjithnjë e më shumë rëndësi.

JOHN DHE JOAN KIRKPATRICK

Pastor i kishës Portrush Presbyterian Church, në Portrush, Irlanda e Veriut

Besojani Jani Ortlund shkrimin e një libri fëmijësh kaq të nevojshëm për martesën! Siç e ka zakon me qartësi dhe çiltërsi, ajo mbulon një sërë temash të rëndësishme në këtë libër të shkurtër dhe i mbështet të gjitha me Shkrime. Mesazhi i ungjillit është i mirëndërthurrur përgjatë librit, ndërsa ajo diskuton me kujdes martesën, divorcin dhe martesën mes së njëjtës gjini, në mënyrë që lexuesit e vegjël t'i kuptojnë. Do të jetë një punë më se e mirëpritur nga prindërit, që kërkojnë të trajnojnë fëmijët e tyre duke i mësuar se mënyra e Perëndisë është gjithnjë më e mira.

MARY K. MOHLER

*Drejtoreshë e Seminary Wives Institute,
The Southern Baptist Theological Seminary në Louisville, Kentucky*

Libri i parë i një fëmije për

MARTESËN

**Mënyra e Perëndisë është
gjithnjë më e mira**



Jani Ortlund

Ilustruar nga Angelo Ruta

Fi njeh me siguri shumë njerëz të martuar – mamin dhe babin tënd, gjyshërit e tu, disa nga hallat dhe dajat, ndoshta fqinjët e tu, mësuesin ose pastorin tënd. Shumë njerëz martohen. A e ke pyetur ndonjëherë veten përse? A ke menduar ndonjëherë, përse mami dhe babi yt u martuan me njëri-tjetrin? Kush e shpiku këtë gjë të quajtur martesë?





*M*artesa ka ekzistuar prej shumë kohësh. Është më e vjetër se prindërit ose gjyshërit e tu. Është më e vjetër se Statuja e Lirisë në Amerikë apo Muri i Madh kinez. Është madje më e vjetër se piramidat e Egjiptit.





*M*artesa nisi që në kopshtin e përsosur të Edenit. Pikërisht aty Perëndia krijoi burrin e parë dhe gruan e parë, dhe pikërisht aty Perëndia krijoi martesën.



Gdhe në këtë kopsht të mrekullueshëm me gjithë ato kafshë për të luajtur, ku dhe Vetë Perëndia i bënte shoqëri Adamit, prapëseprapë diçka mungonte. Perëndia e dinte se Adamit i duhej një person i fortë, i dashur, i zgjuar dhe i sjellshëm. Ai kishte nevojë për dikë që ishte si ai, por në të njëjtën kohë dhe ndryshe nga ai. Perëndia e dinte se Adami kishte nevojë për një grua!

Perëndia bëri gruan e parë, Evën, nga trupi i Adamit. Ajo ishte aq e veçantë, saqë Perëndia e formoi atë në një mënyrë tërësisht të ndryshme nga gjithçka tjetër që Ai kishte krijuar më parë! Dhe pasi Perëndia e krijoi, Ai e çoi atë tek Adami, si babai i nuses në dasmën e parë fare në të gjithë botën (Zanafilla 2:20-22).





Që prej asaj dasme të parë njerëzit kanë vazhduar të martohen. Ashtu si çdo gjë tjetër që vjen nga zemra e Perëndisë, edhe martesë është e bukur dhe e mirë. Perëndia na thotë se martesë është një burrë dhe një grua që i japin njëri-tjetrit gjithçka për gjithë jetën (Mateu 19:4-6; Efesianëve 5:31-33).

Kur një burrë dhe një grua martohen, Perëndia nuk sheh më dy “unë”. Ai sheh një “ne”!



Jezusi thotë se kur një burrë dhe një grua martohen, Perëndia i bashkon në marrëdhënien më të veçantë këtu në tokë. Perëndia i sheh ata të dy si një i vetëm, dhe askush nuk duhet t'i ndajë kurrë (Marku 10:6-9).

Kur një burrë dhe një grua martohen, ata ndajnë zemrat e tyre, mendimet e tyre, madje edhe trupat e tyre! (A i ke parë ndonjëherë mamin dhe babin të puthen? Të martuarit e bëjnë atë gjë!) Ata ndajnë të njëjtin mbiemër, të njëjtat para, të njëjtën shtëpi – madje edhe të njëjtin krevat!



Një burrë dhe një grua bëhen më të veçantë për njëritjetrin sesa për këdo tjetër në të gjithë botën. Kur njëri është i trishtuar, ai ka dikë që kujdeset për të. Kur njëri ka nevojë për një këshillë, ai ka dikë që mund ta pyesë. Kur njëri lëndohet, ai ka dikë që e ndihmon. Kur njëri humb, ata qëndrojnë bashkë, dhe kur njëri fiton, ata gëzohen bashkë!









Disa njerëz mendojnë se për t'u martuar të duhet vetëm dashuria. Ata thonë: “Dashuria e bën martesën.” Epo, dashuria është një pjesë shumë e rëndësishme e saj! Por ka shumë gjëra që njerëzit i duan, si kafshët e tyre, përditimet e bukura, akulloret, por askush nuk martohet me to!

Martesa ka të bëjë me dashurinë, por ka të bëjë më shumë sesa vetëm me dashurinë. Martesa është një zotim, një premtim i shenjtë. Kur një burrë dhe një grua martohen, ata i premtojnë Perëndisë se, pavarësisht gjithçkaje, burri do të qëndrojë me gruan dhe gruaja me burrin për sa të jenë gjallë. Një nuse dhe një dhëndër i bëjnë këto premtime, sepse ndonjëherë është e vështirë të duash njëri-tjetrin. Zotimet e martesës ndihmojnë që një çift të qëndrojë së bashku, edhe kur ata as nuk dëshirojnë ta duan njëri-tjetrin.





Pavarësisht gjithçkaje, burri do të qëndrojë me gruan dhe gruaja nuk do të largohet nga burri për sa të kenë jetë. Mbajtja e çifteve të martuara së bashku është kaq e mirë, sa që shumica e shteteve kanë ligje rreth martesës. Shumica e njerëzve e dinë se martesë midis një burri dhe një gruaje për gjithë jetën e bën një shtet të fortë, sepse u siguron fëmijëve si ti një vend të sigurt për t'u rritur dhe për t'u bërë të fortë. Familjet e sigurta dhe të dashura formojnë komunitete të shëndetshme, dhe komunitetet e shëndetshme nëpër botë dhe në çdo kulturë bëjnë shtete të forta, dhe kështu të gjithë fitojnë!





Go të gjitha shtetet ose drejtuesit e tyre bien dakord se si duhet të jetë martesë, por pavarësisht se ku jeton dhe pavarësisht ligjeve që ai vend ka për martesën, mos u huto! Ekzistojnë ligjet e shtetit dhe ligjet e Perëndisë, dhe ato nuk janë gjithmonë njësoj.





Ajo që Perëndia thotë për martesën ka më tepër rëndësi. Mënyra e Perëndisë është gjithmonë e dashur dhe gjithmonë më e mira. Fjala e Perëndisë, Bibla e Shenjtë, na tregon se çdokush duhet të respektojë dhe të çmojë martesën (Hebrenjve 13:4). Kjo do të thotë se ne duhet të mbajmë premtimet e martesës dhe gjithashtu të ndihmojmë të tjerët që t'i mbajnë. Megjithatë jo gjithmonë jemi të mirë në mbajtjen e premtimeve. Ndonjëherë e kemi më të lehtë t'i thyejmë premtimet sesa t'i mbajmë. Perëndia e kupton që ne jemi të tillë: që ne jemi të thyer dhe bota në të cilën jetojmë, është e thyer (Zanafilla 3:6-7).



Ndonjëherë të rriturit madje i thyejnë premtimet e martesës së tyre. Fatkeqësisht, një martesë mund të bëhet e shëmtuar dhe e dhimbshme. Ndonjëherë mëkati mund të ngurtësojë zemrat tona dhe ne lëndojmë ata që duhet të duam më shumë.

Nëse prindërit e tu janë të divorcuar, kjo të lëndon dhe Perëndia e kupton atë dhimbje. Ai premtun se do të jetë pranë teje, kur zemra jote të jetë e trishtuar (Psalmi 34:18), dhe do të të ndihmojë, kur çdo gjë është kaq e vështirë (Isaia 41:10). Ti mund të flasësh me Të për të gjitha këto.





Disa njerëz ngatërrohen në mënyra të tjetra. Ata mendojnë se mund të ketë martesë ndërmjet dy burrave ose dy grave apo që një burrë mund të ketë më shumë se një grua. Disa njerëz mendojnë se të gjithë do të jenë më të lumtur, nëse bëjnë ç'të duan dhe nëse vendosin vetë si duhet të jetë martesa.

Ndonjëherë ne duam gjërat e gabuara, gjëra që mendojmë se do të na bëjnë të lumtur, por në të vërtetë nuk munden. Perëndia na mëson lumturinë e vërtetë. Ai thotë se lumturia e vërtetë dhe e përhershme vjen vetëm, kur njohim dhe ndjekim Atë (Psalmi 62:1).

Pjesë e të ndjekurit Perëndinë është të besosh atë që Ai thotë për martesën. Martesa nuk është ajo që ne mendojmë se duhet të jetë. Martesa është ajo që Perëndia thotë se duhet të jetë. Pse? Sepse Perëndia na krijoi ne dhe Perëndia krijoi martesën. Perëndia thotë se martesa është ndërmjet një burri dhe një gruaje gjatë gjithë jetës, dhe mënyra e Perëndisë është gjithmonë e dashur dhe më e mira.





Support
Gay
Marriage

GET
RICH
QUICK

Divorce
rates increase

HAVE
IT
ALL




Anjuh dikë që nuk beson atë çfarë Bibla thotë për martesën, ndoshta dikë në lagjen tënde apo në familjen tënde? Nuk duhet të jesh i pasjellshëm apo të thuash gjëra të këqija për ta. Perëndia do që të jesh i dashur dhe i sjellshëm, dhe mënyra e Perëndisë është gjithnjë më e mira (Zakaria 7:9; Titit 3:4-5).

Një ditë edhe ti mund të martohesh. Do të jetë e mrekullueshme! Por martesë do të jetë edhe e vështirë. Është e vështirë të mos jesh egoist, kur jeton gjatë gjithë kohës, çdo ditë të jetës me dikë tjetër. Është e vështirë të vendosësh dikë para vetes tënde. Por është e mundur gjithashtu që një martesë të jetë marrëdhënia më e dashur, më e thellë dhe më e lumtur, që ti do të kesh me një njeri tjetër!




*Por jini të mirë dhe
të përdëlllyeshëm
njëri me tjetrin,
duke e falur njëri-
tjetrin, sikurse edhe
Perëndia ju ka
falur në Krishtin.
Efesianëve 4:32*






Një martesë biblike i tregon botës një pamje të vogël të Romancës së Madhe - asaj midis Krishtit dhe kishës së Tij në dashuri së bashku. Kur e do Jezusin, ti je pjesë e asaj kishe dhe asgjë e askush nuk do të mund të të ndajë nga dashuria që Perëndia ka për ty (Romakëve 8:38-39).



Sa i mirë është Perëndia, që na ka dhënë martesën. Le ta trajtojmë martesën me nderim dhe të falënderojmë Perëndinë për këtë dhuratë (Hebrenjve 13:4). Mendo për këtë! Martesa u sjell gëzim të rriturve. Martesa është e mirë për fëmijët.

Martesa ndihmon që komunitetet të qëndrojnë të sigurt dhe i bën shtetet të forta.





*M*ë e mira nga të gjitha është që martesat
është një shfaqje e afërt e dashurisë së
përjetshme të Jezusit për popullin e Tij.





**Mënyra e Perëndisë
është gjithnjë më e mira!**





I dashur Atë qiellor,
Faleminderit për dhuratën tënde
të bukur të martesës!
Faleminderit për Biblën,
që na mëson se çfarë është
dhe çfarë nuk është martesë.
Faleminderit që të gjitha rrugët e tua
janë të dashura dhe të mira
dhe që ne mund të të besojmë
gjithçka: zemrat tona, familjet tona
dhe gjithë jetët tona.
Të lutem na jep hir
që të të njohim dhe të të
besojmë më shumë.
Në emrin e Krishtit,
Amen.

I dashur Prind,

Shpresoj që ky libër të jetë një mjet ndihmues për ty, ndërsa fëmija yt kupton se si formohen familjet. Fëmijëve u pëlqen të bëjnë si të rritur dhe të bëjnë gjërat, që bëjnë të rriturit. Ata shohin lloje të ndryshme familjesh me cilësi të ndryshme prindërimi, dhe kjo mund t'i hutojë.

Përse të mos i ndihmojmë fëmijët që në një moshë të hershme, në mënyrë që të kuptojnë në zemrat e tyre atë që Perëndia mëson për martesën? Përse të mos u japim fëmijëve të vegjël një vizion të asaj, që në mirësinë e Perëndisë, mund të vijë më vonë në jetën e tyre?

Përdore këtë libër gjatë përkushtimeve familjare, ndërsa gjen shkrime biblike rreth dashurisë martesore. Lexoje me fëmijën



tënd, kur dikush i afërt do të martohet. Jepja vajzës që mban unazat në një martesë, apo që hedh lulet para nuses. Ndaje me familjen, ndërsa afrohet përvjetori yt i martesës dhe tregoji për mrekullitë e historisë tënde të dashurisë. Lutuni së bashku për bashkëshortin/ten e tij/saj të ardhshme.

Sido që të zgjedhësh ta përdorësh këtë libër, ndihmoje fëmijën tënd të kultivojë dashurinë dhe besimin në Atin qiellor. Tregojtu të gjithë të vegjëlvë, që ke mundësi t'i ndikosh, se ti beson me gjithë zemrën tënde se mënyra e Perëndisë është gjithnjë më e mira!

JANI ORTLUND



Titulli në origjinal: A Child's First Book about Marriage

E drejta e autorit © 2018 Jani Ortlund

Ilustrimet nga Angelo Ruta

Arti grafik i kopertinës: Tom Barnard



Ky libër u mundësua në gjuhën shqipe nga qendra “IGNIS”.
Për më shumë materiale të tjera nga qendra “IGNIS”, vizitoni faqen www.dritez.al

Përktheu: Sara Gjana

Redaktoi: Vilma Dina

Përshtatja e faqosjes në shqip: Vision Printing shpk

Të gjitha citimet biblike, nëse nuk thuhet ndryshe,
janë marrë nga Bibla ABS, përdorur me leje nga Albanian Bible Society (A.B.S.)

Të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të vendoset në ndonjë sistem ose të transmetohet nëpërmjet çdo forme apo mënyre elektronike, mekanike, fotokopjimi, inçizimi apo në ndonjë mënyrë tjetër pa marrë më parë leje me shkrim nga botuesi.

Ti njeh me siguri shumë njerëz të martuar – mamën dhe babin tënd, gjyshërit e tu, disa nga hallat dhe dajat, ndoshta fqinjët e tu, mësuesin ose pastorin tënd. Shumë njerëz martohen.

A e ke pyetur ndonjëherë veten përse?

Martesa nisi që atëherë kur Perëndia krijoi burrin e parë dhe gruan e parë.

Që prej asaj dasme të parë njerëzit kanë vazhduar të martohen.

Ashtu si çdo gjë tjetër që vjen nga zemra e Perëndisë, edhe martesa është e bukur dhe e mirë.

Shumë njerëz hamendësojnë se martesa është diçka për të cilën njerëzit duhet të fillojnë të mendojnë, kur janë rreth të njëzetave apo të tridhjetave. Ky libër i njeh fëmijët me bukurinë e tablosë së ungjillit të Perëndisë në martesë dhe në familje, në një mënyrë që fëmijët mund ta kuptojnë dhe ta duan.

Russell Moore, President i “Ethics and Religious Liberty Commission, the Southern Baptist Convention”

Mesazhi i ungjillit është i mirëndërthtur përgjatë librit, ndërsa ajo diskuton me kujdes martesën, divorcin dhe martesën mes së njëjtës gjini, në mënyrë që lexuesit e vegjël t`i kuptojnë.

**Mary K. Mohler, Drejtoreshë e “Seminary Wives Institute”,
“The Southern Baptist Theological Seminary” në Louisville, Kentucky**

... një ndihmë e madhe për çdo prind, që kujdeset vërtetë të ushqejë dhe të formësojë zemrën e fëmijës së vet në gjërat që kanë vërtetë rëndësi, në një kohë kur ato kanë gjithnjë e më shumë rëndësi.

John dhe Joan Kirkpatrick, Pastor i kishës “Portrush Presbyterian Church”, në Portrush, Irlanda e Veriut

Me ilustrime tepër të mira, ai ndan me çiltërsi të vërtetën e Perëndisë për martesën, ndërkohë që merret dhe me çështje të vështira. Është një pikënisje shumë e mirë për fëmijët e vegjël.

Susan Alexander Yates, Autore e librit “And Then I Had Kids and Risky Faith”

.....
**Jani Ortlund është një
bashkëshorte, nënë, dhe gjyshe.
Ajo, gjithashtu, shërben si zv. presidente
e shërbesës “Renewal Ministries”**
.....



Ky libër u mundësua në gjuhën shqipe nga qendra “IGNIS”.
Për më shumë materiale të tjera nga qendra “IGNIS”, vizitoni faqen www.dritez.al